



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIVJAKË  
DREJTORIA E BUJQËSISË, MJEDISIT, MENAXHIMIT TOKËS DHE PYJEVE

Nr. 3997 / Prot. 12

Divjakë, më: 15/05 /2026

PROJEKT-VENDIM

Nr. 47, datë 15/05 /2026

**PËR**  
**MIRATIMIN E DHËNIES SË NDIHMËS FINANCIARE SHTETASVE TË CILËVE U**  
**JANË DËMTUAR BANESAT NGA FATKEQËSI TË NDRYSHME**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, neni 7, neni 30, gërma (gj), dhe neni 41, në VKM nr.329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, në VKM nr.414, datë 8.7.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” pika 3.1, gërma (a), i propozojmë Këshillit Bashkiak të Bashkisë Divjakë,

- 1.Të miratoj dhënien e ndihmës financiare për shtetasin z.Mustafa Muça, banesa e të cilit është shembur në masën 60%, si pasojë e rrëshqitjes së dheut dhe sipërfaqja e ndërtimit është 114.6 m<sup>2</sup>.
- 2.Z.Mustafa Muça t’i akordohet ndihma financiare në masën 50% të vlerës së përlllogaritur, e cila është 3.157.803 lekë : 2= 1.578.901 lekë. Me Vendimin e Këshillit të Komunës Remas nr. 15, datë 31.03.2010, z.Mustafa Muça ka përfitur ndihmë të menjëhershme në vlerën 50.000 lekë të cilat zbriten nga ndihma financiare. Vlera përfundimtare e përlllogaritur që do të përfitojë z.Mustafa Muça për dëmin e shkaktuar është 1.578.901 lekë – 50.000 lekë = 1.528.901 lekë.
3. Të miratoj dhënien e ndihmës financiare për shtetasin z.Erjon Shehu, banesa e të cilit është dëmtuar nga shirat dhe tërmeti i viti 2019, bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak Divjakë nr.30, datë 25.07.2022.
- 4.Z.Erjon Shehu t’i akordohet ndihma financiare në masën 50% të vlerës së përlllogaritur, e cila është 1.705.428 lekë : 2 = 852.714 lekë, është vlera që do të përfitoj.

Adresa: Sheshi “Santa Barbara” Divjakë, info@bashkiadivjake.gov.al

5. Të miratoj dhënien e ndihmës financiare për z.Ernest Lazja, banesa e të cilit është dëmtuar si pasojë e rënies së zjarrit.
6. Z.Ernest Lazja, t'i akordohet ndihma financiare në masën 50% të vlerës së përlogaritur, e cila është 572.902 lekë : 2 = 286.451 lekë, është vlera që do të përfitoj.
- 7.Të miratoj dhënien e ndihmës financiare për z.Fatmir Kacabumi, banesa e të cilit është dëmtuar rëndë nga shirat e muajit janar-shkurt 2026.
- 8.Z.Fatmir Kacabumi t'i akordohet ndihma financiare në masën 50% të vlerës së përlogaritur, e cila është 2,661,900 lekë :2 = 1,330,950 lekë është vlera që do të përfitoj.
9. Të miratoj dhënien e ndihmës financiare për z.Bujar Manaj, banesa e të cilit është dëmtuar nga shirat e muajit janar-shkurt 2026.
10. Z.Bujar Manaj t'i akordohet ndihma financiare në masën 50% të vlerës së përlogaritur, e cila është 2,056,850 lekë : 2 = 1,028,425 lekë është vlera që do të përfitoj.
11. Burimi i financimit është nga fondi i kushtëzuar për vitin 2026, transferuar nga Ministria e Mbrojtjes, programi “Emergjencat civile”, artikulli 604, kodi i produktit 91707AB “shtetas të ndihmuar banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme”.

**Specialist agronom dhe emergjencave civile**

Ferit Qosja



**Përgjegjës sektorit juridik, prokurimeve publike dhe menaxhimit të aseteve**

Andi Bullari



**Drejtori drejtorisë financës dhe buxhetit**

Xheladin Brahkola



**KRYETARI**

Josif GORREA

